VENDIM
Nr.190, datë 17.3.2010

PËR KRYERJE PAGESASH, NË FORMË KONTRIBUTI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES NË FONDIN E PËRBASHKËT TË NATO-S DHE PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE NDËRMJET PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR KËTË MINISTRI, NË BUXETIN E VITIT 2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Per buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet njësisë shpenzuese, Drejtoria e Administratës dhe Shërbimeve, të kryejë pagesën, në vlerën 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë, në formë kontributi, në fondin e përbashkët të NATO-s, për të mbështetur ngritjen e Forcës së Sigurisë në Kosovë.

2. Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet njësisë shpenzuese, Drejtoria e Administratës dhe Shërbimeve, të kryejë pagesën, në vlerën 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, në formë kontributi, në fondin e përbashkët të NATO-s, për të mbështetur nismën "HIP Helicopter Task Force" (HIP HTF).

3. Në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar për vitin 2010, të bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin 01110 "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi", artikulli 605 "Transferta korrente të huaja", të shtohet fondi prej 77 000 000 (shtatëdhjetë e shtatë milionë) lekësh për Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimit në këtë Ministri.

b) Në programin 02150 "Mbështetja e luftimit", në shpenzimet korrente, artikulli 602 "Mallra dhe shërbime", të pakësohet fondi prej 77 000 000 (shtatëdhjetë e shtatë milionë) lekësh, për repartin ushtarak nr.4300, Tiranë.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar për vitin 2010.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha